37.554

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR
TIRANE

Nr. 37 554 Vendimi

## VENDIM
## PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane, sot me date 21. 02. 2007 ( dymije e shtate ), une Gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane, Ilirjana Lleshi, mora ne shqyrtim kerkesen dhe aktet e paraqitura nga kerkuesi Erald SHUAIPI , administrator i shoqerise " C.A.A" shpk dhe :

KONSTATOVA

Se shtetesi Erald SHUAIPI ka themeluar sipas aktit të themelimit dhe statutit të nenshkruar prej tij shoqerine me pergjegjesi të kufizuar me emertimin " C.A.A" shpk.
Selia e shoqerise eshte ne Tirane , Bulevardi " Zhan D'Ark " Nr.64.
Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, i zoteruar nga ortaku ivetem Erald SHUAIPI, zoterues i 100 % te kapitalit te shoqerise me vlere 100.000 ( njeqind mije )leke.
Kohezgjatja e aktivitetit të shoqerise eshte mbi 10 vjet.
Administrator i pergjithshem i shoqerise eshte Erald SHUAIPI .
Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :
Tregetim me pakice e shumice, import eksport te mallrave te ndryshme industriale te lejuara nga ligji dhe autovetura.

Pasi shqyrtova kerkesen , aktin e themelimit dhe statutin e paraqitur nga kerkuesi konstatoj se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje të Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare ", dhe Ligjit nr. 7667 date 28.01.1993, " Per Regjistrin Tregtar ".

VENDOSA

-Pranimin e kerkeses.

-Regjistrimin si person juridik të shoqerise me pergjegjesi të kufizuar me emertimin "C.A.A" SH.P.K, ne rregjistrin tregtar te gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane.

Selia e shoqerise eshte ne Tirane , Bulevardi " Zhan D'Ark " Nr.64.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke, i zoteruar nga ortaku i vetem Erald SHUAIPI , zoterues i 100 % te kapitalit te shoqerise me vlere 100.000 leke.

Kohezgjatja e aktivitetit të shoqerise eshte mbi 10 vjet.

Administrator i pergjithshem i shoqerise eshte Erald SHUAIPI .

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

Tregetim me pakice e shumice, import eksport te mallrave te ndryshme industriale te lejuara nga ligji dhe autovetura.

Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

Tirane, me 21-02-2007

GJYQTARE

Ellona Aliu

## AKTI THEMELIMIT I SHOQERISE
## ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### " C.A.A " SHPK

Neni 1

Shoqeria private " C.A.A" shpk , formohet nga themeluesi Erald SHUAIPI i biri i Spartak dhe Natasha me datelindje 11 Maj 1976, lindur ne Tirane , banues ne Tirane Rr. M.Shyri , pall.1 shk.12 Ap.93 , mbajtes i pasaportes Nr. Z1109476

Neni 2

Selia e Shoqerise eshte ne Tirane .Bulevardi " Zhan D'ark" Nr.64, shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me zgjerimin e aktivitetit , me miratimin e ortakut te vetem.

Neni 3

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj : Tregetim me pakice e shumice, import eksport te mallrave te ndryshme industriale te lejuara nga ligji dhe automjete.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj me afat jo me pak se 10 vjet, te marre si vite kalendarike duke filluar nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar.

Neni 5

Kapitali themeltar I shoqerise eshte 100.000 ( njeqind mije leke ).

Ky kapital eshte teresisht I nenshkruar dhe I shlyer nga ortaku I vetem.

Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalin e saj , me miratimin e ortakut themelues.

Neni 6

Organi me i larte i drejtimit te shoqerise eshte oraku i vetem, organi vendimor.

Shoqeria mund te administrohet :

- Nje administrator unik i vetem , aktualisht Erald Shuaipi
- Dy administrator me nje firme te perbashket ose te vecante per sejcilin.

Neni 7

Shtimi i ortakeve :

- Kur ortaku i vetem eshte dakort . qe te behen shtesa kapitali , me ane te personave te tjere qe keta te konsiderohen ortake , duhet te veprohet keshtu :
  Se pari meret vendim nga ortaku i vetem, ku shqyrtohet kerkesa e te interesuarit, behet pranimi dhe percaktohet kuota e kapitalit qe do te dershe ortaku I ardhshem.
  Se dyti behet rregjistrimi ne librin e ortakut ku shkruhet emri I plote I ortakut te ri dhe kuota me kapitalin social.
  Veprimi I bashkimit te ortakut te ri , duhet te behet me nje akt noterial.

THEMELUESI I SHOQERISE

Erald SHUAIPI

Erald Shuaipi

# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### " C.A.A" SH.P.K

### FORMA, BAZA JURIDIKE , SELIA

Neni 1

Shoqeria private " C.A.A " SHPK formohet nga themeluesi Erald SHUAIPI i biri i Spartak dhe Natasha me datelindje 11 Maj 1976, lindur ne Tirane , banues ne Tirane Rr. M.Shyri , pall.1 shk.12 Ap.93 , mbajtes i pasaportes Nr. Z1109476

Neni 2

Shoqeria eshte person juridik dhe eshte krijuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe si e tille fillon aktivitetin me rregjistrimin e saj ne rregjistrin tregtare.

Neni 3

Qendra e Shoqerise eshte ne Tirane, me seli Bulevardi "Zhan D'ark ", Nr.64. Shoqeria mund te ndryshoje seline e vet , me miratimin e ortakut te vetem.

Neni 4

Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptare dhe me statutin e saj , ne teritorin e Shqiperise dhe jashte saj.

Shoqeria mund te krijoje filiale ne vende te tjera ne perputhje me legjislacionin e vendit perkates.

Neni 5

Shoqeria me Pergjegjesi te kufizuar i perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit te investuar ne te.

### LIBRI I SHOQERISE

Neni 6

Per te precizuar dhe saktesuar veprimtarine e vet ekonomike dhe maredheniet e punes , shoqeria do te cel librin e vet, i cili do te quhet libri i shoqerise.

KONFIDENCIALITETI

Neni 7

Ortaku vete dhe per persona te caktuar ne shoqeri, bie dakort qe te mos i ekspozoje asnje personi te jashtem informacionet qe do te disponoje shoqeria, kontratat qe ajo do te lidhe , si dhe planet dhe qellimet qe ajo ka per te ardhmen e saj.

Neni 8

Te gjitha aktet dhe dokumentat e tjera qe nxirren nga shoqeria dhe te destinuara per te tretet si faturat , letrat , lajmerimet dhe publikimet e ndryshme , duhet te tregojne lexueshem emrin e shoqerise dhe pas saj fjalet " SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " ose inisialet " SH.P.K , kapitalin themeltar dhe emrin e administratorit.

Neni 9

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj :
Tregetim me pakice e shumice, import eksport te mallrave te ndryshme industriale te lejuara me ligj dhe automjete.

KOHE ZGJATJA E SHOQERISE

Neni 10

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj jo me pak se 10 vjet , te marre si vit kalendarik, duke filluar nga data e rregjistrimit ne Rregjistrin Tregtare.

KAPITALI THEMELTAR

Neni 11

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 ( njeqind mije ) leke te reja .
Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetem .
Shoqeria mund te shtoje ose te pakesoje kapitalin e saj me miratimin e ortakut themelues.

Neni 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme , ndermjet ortakeve,( neqofte se do te kete te tille ne te ardhmen) , gjithashtu pjeset e kapitalit themeltar mund ti transferohen edhe te treteve , me miratimin e ortakut te vetem. Ato jane lirisht te transferueshme, ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si rruge trashegimie. Transferimet e pjeseve dhe kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial.

## STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 13

Shoqeria , do ta konsideroje qendren e vet ne adresen Bulevardi " Zhan D'ark " Nr.64 Tirane, si shoqeri nene, e cila rast pas rasti do te hapet edhe ne filiale te tjera, ose shoqeri te perbashketa ne te gjitha ato vende ku do te shikoje interes ne permbushjen e qellimit te saj, ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Neni 14

Organi me i larte i drejtimit te shoqerise eshte ortaku/ja i/e vetem/e , organi vendimor.
Shoqeria mund te administrohet nga :

- Nje administrator unik i vetem aktualisht Z.Erald SHUAIPI
- Dy administrator me nje firme te perbashcet ose te vecante per sejcilin.

Neni 15

Administratori ose administratoret ( n.q.se do te kete), mund te jene ose jo ortake, sipas percaktimit te ortakut te vetem.

Administratori shkarkohet me vendim te ortakut ose kur jep vete doreheqjen .

Neni 16

Administratori unik dhe i autorizuar i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne maredhenie me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne te gjitha rrethanat .

Ai ka te drejte te marre pjese ne shitje , ne blerje , ne procedurat e falimentimit, te hartoje kontrata te karaktereve te ndryshme, te tjetersoje pasuri te lujteshme e te palujteshme te hape llogari rrjedhese prane bankave shqiptare dhe te huaja si dhe te depozitoje para, operfaqesoje shoqerine ne maredhenie me te tretet dhe ne organe gjyqesore dhe administrative etjera.

## LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 17

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel ose librave te tjere edhe keto libra:

-Libri i ortakut ne te cilin shonohet emri i plote i tij dhe kuota e kapitalit themeltar.
-Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit vendimor.
-Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit administrative.

## BILANCI

Neni 18

Bilanci mbyllet ne 31 Dhjetor te cdo viti . ku i pari do te jete me 31 Dhjetor 2007.

Llogarite vjetore, inventari , raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel, i autorizuar nga ortaku i vetem . miratohet nga ai, miratimi i ketyre dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 4 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

## DIVIDENTET

Neni 19

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve , percaktohet pjesa qe i takon ortakut themelues , ne formen e dividentit mbi fitimin.

Ky fitim perbehet nga fitimi i vitit financiar , te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin reserve te domozdoshem te percaktuar nga ortaku, te fondeve te tjera qe shihen te nevojshme nga ana tjeter jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

## SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 20

Shoqeria prishet kur ka nje prishje te parakohshme, per arsye te parashikuara ne ligj.

Neni 21

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne procesin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi , ortaku cakton nje ose disa likujdues, te cilet I paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te shoqerise, ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likujdimit, ortaku vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates ( ne se ka te tille ) , likujduesi ndan kapitalin per ortakun themelues.

## MAREDHENIET PER PUNESIM

Neni 22

Kriteret e pergjitheshme te punesimit te personave te tjere, numrin e tyre, kufijte e pageses dhe detyrat e secilit ne shoqeri, percaktohen nga ortaku i vetem.

Punesimi i personave ne shoqeri kryhet mbi bazen e kontrates individuale te punes te hartuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 23

Shoqeria mer persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore per te gjithe te punesuarit ne te, ndersa keta te fundit duhet te pranojne kete statut.

Te punesuarit pergjigjen sipas ligjit dhe sipas ketij statuti per moszbatimin e detyrave dhe demeve qe ata I shkaktojne shoqerise.

Neni 24

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise , ose gjate periudhes se likujdimit , qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve do te tentohet te zgjidhen me mirekuptim ne te kundert do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente shqiptare konform legjislacionit shqiptare.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 25

Shtimi i ortakeve :

Kur ortaku i vetem eshte dakort qe te behen shtesa kapitali, me ane te personave te tjere , qe keta te fundit te konsiderohen ortake duhet te veprohet keshtu:

- Se pari, meret vendim nga ortaku i vetem, ku shqyrtohet kerkesa e te interesuarit, behet pranimi dhe percaktohet kuota e kapitalit qe do te dershe , ortaku i ardhshem.
- Se dyti behet rregjistrimi ne librin e ortakut ku shkruhet emri i plote i ortakut te ri dhe kuota ne kapitalin social.
- Veprimi i shtimit te ortakut te ri duhet te behet me nje akt noterial.

Neni 26

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut I referohet plotesimeve te metejshme me ane amendamentesh sa here qe e sheh te arsyeshme, ortaku themelues I kesaj shoqerie.

Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre dhe procedure me te cilen behet vete nxjerja e ketij statuti.Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te shoqerise.

Ky statut eshte hartuar ne 4 kopje . shqip dhe pasi gjendet sipas vullnetit te hartueses dhe ligjit, nenshkruhet rregullisht.

**ORTAKU I VETEM**
Erald SHUAIPI

ULLE TAKSE 100 LEKE SHQIPERISE

37554

Z. E. Dluri 09.02.2007

0 9 FEB. 2007

# KERKESE

**KERKUESE** : ERALD SHUAIPI , i biri i Spartak dhe Natasha, me datelindje 11 Maj 1976, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, Rr. " M.Shyri "pall.1, shk.12, ap.93, me pasaporte Nr. z1109470

**ME OBJEKT** : Rregjistrimin si person juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " C.A.A " Sh.p.k , ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregtare " dhe Nr. 7667 date 28.01.1993 " per regjistrin tregtar ".

PERPARA GJYKATES SHKALLES PARE

TIRANE

Une kerkuesi Erald Shuaipi,
paraqes para Gjykates kete kerkese per rregjistrimin si Person Juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar : " C.A.A " me qender ne Tirane, me adrese Bulevardi Zog.I-re, Nr.64
Ortaku i vetem i shoqerise do te jete Z. Erald SHUAIPI.
Kapitali themeltar I shoqerise do te jete ne kuoten 100.00(njeqind mije )leke
Objekti I veprimtarise do te jete :
Tregetim me pakice e shumice, import eksport te mallrave te ndryshem.
Kohezgjatja do te jete prej 10 vjetesh.
Administratori i shoqerise do te jete **Erald Shuaipi.**
Ne perfundim kerkoj pranimin e kerkeses.

KERKUESI
Erald SHUAIPI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. REP. 300
NR. KOL. 97

VERTETIM

Sot me date 8.02.2007 ,para meje noteres MIRKA PAPA , ne zyren e Noterise qe ndodhet ne Rr. "Asim Vokshi", Pall.49/1, u paraqit personalisht :
**Erald SHUAIPI,** i biri i Spartak dhe Natasha , me datelindje 11 Maj 1976, lindur ne Tirane , banues ne Tirane Rr. "M.Shyri" , pall.1 shk.12 Ap.93 , madhore, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e pasaportes Nr. Z1109476, i cili deklaroi se kerkesa per rregjistrimin ne Gjykate te shpk" C.A.A", eshte nenshkruar prej tij.

Nenshkrimi u be ne prani te noteres.

Sa me siper vertetohet prej meje noteres.

PULLE TAKSE
100 LEKE

NOTERE
MIRKA PAPA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. REP. 301
NR. KOL. 18

## PROKURE E POSACME

Sot me date 8.02.2007 ( dymije e shtate ) para meje noteres , MIRKA PAPA , ne zyren e noterise qe ndodhet ne Rr. " Asim Vokshi " Pall.49/1, u paraqiten personalisht :

**ERALD SHUAIPI** , i biri i Spartak dhe Natasha, me datelindje 11 Maj 1976, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, Rr. " M.Shyri "pall.1, shk.12, ap.93, me pasaporte Nr. Z1109476

I perfaqesuari kerkoi redaktimin e kesaj prokure te posacme me permbajtje si me poshte vijon :

Emeroj perfaqesues me anen e kesaj prokure avokatin e Dhomes se Avokatise Tirane, Z. Alfred BALLA, me License Nr.776 , i cili ka drejte qe ne emer e per llogarine time te kryej veprimet e nevojshme per rregjistrimin e shoqerise **"C.A.A" SHPK** ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Prokura mbaron sipas rasteve te parashikuara ne ligj.

Veprimet e kryera nga perfaqesuesi me prokure sipas tagrave te ngarkuara prej meje , une i perfaqesuari i konsideroj njesoj si te kryera nga vete ne , perderisa ato nuk vijne ne kundershtim me interesat e mia dhe me ligjin .

Prokura si u lexua dhe u pa qe eshte shkruar drejte , ne perputhje me vullnetin e perfaqesuesit , nenshkruhet prej tij pa verejtje.
Ne mbeshtetje te nenit 70-77 te K.Civil, kjo prokure nenshkruhet edhe prej meje noteres.

I PERFAQESUARI

NOTERE
MIRKA PAPA

Banka Popullore

# GARANCI PER REGJISTRIM NË GJYKATË

**Nr .** 029 **Data 08/02/2007**

Me këtë dokument vërtetojmë se **Z. ERALD SHUAIPI** ka ngurtësuar pranë **Banka Popullore Sh.a** me adresë Bulevardi Zogu I, Tiranë shumën prej **100.000 LEK** (njëqind mijë LEK) si kapital themeltar për krijimin e shoqërisë **" C. A. A. " Sh.p.k .**

**Shpresa Zeqiraj**

Drejtor I Deges

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. REP. 302
NR. KOL. 97

VERTETIM

Sot me date 08.02.2007 ( tete shkurt dymije e shtate ),para meje noteres MIRKA PAPA , ne zyren e Noterise qe ndodhet ne Rr. "Asim Vokshi", Pall.49/1, u paraqit personalisht :
**Erald SHUAIPI,** i biri i Spartak dhe Natasha , me datelindje 11 Maj 1976, lindur ne Tirane , banues ne Tirane Rr. "M.Shyri" , pall.1 shk.12 Ap.93 , madhore, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pasaportes Nr. Z1109476, i cili deklaroi se statuti dhe akti i themelimit te " C.A.A" sh.p.k, eshte nenshkruar prej tij.

Nenshkrimi u be ne prani te noteres.

Sa me siper vertetohet prej meje noteres.

PULLE TAKSE
100 LEKE

NOTERE
MIRKA PAPA